

**KURS RRETH SUPERVIZIMIT TE SIGURUESVE BAZUAR NE
PARALAJMËRIMIN E HERSHEM DHE AFTËSINË PAGUESE**

MODULI 3

ANALIZE RAPORTI E MONITORIMIT TE KUJDESSHËM NE DISTANCE

**RODNEY LESTER
SERAP GONULAL
THE WORLD BANK
29 NËNTOR 2006**

VËSHTRIM I PERGJITHSHEM I MBIKËQYRJES SE SIGURIMEVE

1. Historikisht ka pasur dy përjasje të gjera të aplikuara ndaj mbikëqyrjes së sigurimeve. Njëra, që ka qenë ajo preskriptive, e mbështetur mbi përjasjen e auditimit ka karakterizuar vendet e Kodit Civil¹ dhe që sheh një rol kryesor të shtetit në mbikëqyrjen dhe drejtimin e sektorit financiar. Kjo qasje, ndonëse kufizon spektrin e mundësive për humbje, ka kufizuar edhe novacionet në prodhim dhe shpërndarje dhe zhvillimin e përgjithshëm të tregut. Kjo, gjithashtu, e ekspozon mbikëqyrësin ndaj përgjegjësisë ligjore në disa juridiksione nëse ndodh një dështim ose humbje. Modeli tjetër, i cili vjen kryesisht nga tradita e Common Law², është ai që ka një përjasje kryesisht të karakterit mosndërrhyrës, ku mbikëqyrësi mban një qëndrim shumë të distancuar deri në atë moment që siguruesi është në një rrezik të qartë dështimi. Një seri dështimesh të mëdha të siguruesve në vendet e traditës së Common Law gjatë 20 viteve të fundit ka çuar në një përjasje me ndërhyrëse, megjithëse është ruajtur akoma një model tregu i konkurrencës. Të dy modelet tani po konvergojnë drejt asaj që njihet si përjasje e mbështetur mbi riskun, e cila pranon se mjetet mbikëqyrëse janë shpesh të kufizuara dhe se veprimi mbikëqyrës duhet të përqendrohet në ato institucione që janë në risk me të lartë dështimi.
2. Modeli i mbikëqyrjes që do të përdoret për këtë kurs bazohet në përjasjen e Shoqatës Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (NAIC). Kjo është dezignuar për t'u marrë me 55 juridiksione të ndryshme shteti, distrikti dhe territoriale të cilat kanë aftësi, burime dhe struktura tregu që ndryshojnë shumë nga njëra tjetra dhe që është, pra, një përjasje relativisht e vetëpërmbytur dhe globale, megjithëse lejon ndërmarrjen e veprimeve suplementare në nivel lokal. Shoqata Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (NAIC) ndërmerr ekzaminime të rregullta të certifikimit të mbikëqyrësve në nivel shteti në kuadër të një përpjekjeje për të ruajtur standarde të qëndrueshme neper të gjithë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
3. Modeli i Shoqatës Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (NAIC) sheh tre faza thelbësore të mbikëqyrjes:
 - a. 'Organizimin e monitorimit në distancë të situatës financiare duke përdorur pasqyrat financiare dhe analizën e informacionit të tregut si dhe ekzaminimet në vend;
 - b. implementimin e planit korrektues të veprimit për kompanitë e dobësuar financiarisht; dhe
 - c. ndërmarrjen e procedurave të falimentimit'³
4. Ndonëse përfshihen tre faza baze, disa vende me modele mbikëqyrëse dhe rregullatore me të centralizuara kanë zbatuar deri në pesë faza mbikëqyrëse të dallueshme dhe të lidhura të njohura si shkalla rregullatore. Kjo sheh veprim dhe ndërhyrje të shtuar nga

¹ Sistemi Romano-Gjermanik i së Drejtes (Shenim i Perkthyesit)

² Sistemi Anglo-Sakson i së Drejtes (Shenim i Perkthyesit)

³ Nga një raport i përbashkët i Shoqatës Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (NAIC) and të Sistemit të Rezervës Federale - Prill 2005

ana e mbikëqyrësit kur përkeqësohet pozita e një kompani sigurimi. Përjasja e përdorur ne Kanada jepet ne Aneksin 1. Një numër vendesh ne zhvillim kane aprovuar shkalle rregullatore te thjeshtëzuara.

5. **Ekzistojnë dy mjete thelbësore te jashtme qe përdoren nga mbikëqyrësi sipas modeli modern te mbikëqyrjes per te përcaktuar nëse një sigures ka nevojë per një mbikëqyrje me nga afër, një ndërhyrje apo per masa shtrënguese. Këta janë indikatorë paralajmërues te hershem dhe masa lidhur me aftësinë paguese.** Indikatorët paralajmërues te hershem tentojnë te nxisin ndërhyrjen paraprake nga ana e mbikëqyrësit, ndërkohë qe masa lidhur me aftësinë paguese nxisin veprimet shtrënguese kur një sigures i afrohet pikës ne te cilën ai mund te vonoje plotësimin e detyrimeve te tij ndaj te siguruarve. Megjithëse ky modul merret kryesisht me masat per paralajmërimin e hershem (dhe ndërhyrjen), ne te është përfshire edhe një vështrim i përgjithshëm i koncepteve moderne te aftësive paguese meqenëse dy grupet e mjeteve janë te lidhura nëpërmjet shkalles rregullatore.

INDIKATORËT E PARALAJMËRIMIT TE HERSHEM - ANALIZE E RAPORTIT NE DISTANCE

6. Metodologjia e përdorur sipas sistemit te Shoqatës Kombëtare te Komisionerëve te Sigurimit te Shteteve te Bashkuara te Amerikës (NAIC) per te ekzaminuar siguresit dhe per te dhënë paralajmërim te hershem është FAST, ose sistemi i Mjeteve te Analizës Financiare te Aftësisë Paguese. Ai ka tre nen-komponentë:
- (i) IRIS, ose Sistemi i Informacionit Rregullator te Sigurimeve – ky përbëhet nga a) një seri raportesh te nxjerra nga fitimet periodike te ligjshme te një siguresi qe janë te disponueshme per publikun dhe b) një renditje konfidenciale e siguresve ne rrezik bazuar ne një analize me te detajuar te këtyre siguresve, raportet e IRIS-it (Sistemi Rregullator i Informacionit te Sigurimeve) te të cilëve dhe pune te tjera analitike tregojnë nevojën e rishikimit te mëtejshëm.
 - (ii) Një sistem pikesh vlerësimi qe lidh IRIS-in (Sistemi i Informacionit Rregullator te Sigurimeve) dhe disa faktore te tjerë me mundësinë e problemeve qe lidhen me aftësinë paguese, bazuar ne një analize statistikore te përvojës se mëparshme.
 - (iii) Sistemi i profilin te siguresit, i cili identifikon trendet (qofte tremujore apo vjetore) per një periudhe mbi 5 vjeçare dhe thekson luhajtjet e pazakonta.
7. Informacioni qe i kërkohet siguresit per t'ia dhënë çdo vit mbikëqyrësit sipas modelit te Shoqatës Kombëtare te Komisionerëve te Sigurimit te Shteteve te Bashkuara te Amerikës (NAIC) përfshin sa me poshtë vijon:
- (i) Informacion te plote te raportimit financiar - bilanci, pasqyra e humbjeve dhe e fitimeve, pasqyra e qarkullimit te kesh-it, shënimet e llogarive dhe shume përgjigje per pyetje te veçanta lidhur me çështje te tilla si investimet, te ardhurat e investimeve, asetet te panjohura, risigurimi dhe transaksione te palëve përkatëse.
 - (ii) Zëra qe përfshijnë dokumente qe kane te bëjnë ne auditimin e jashtëm, me opinionin aktuar dhe raportin per kapitalin e bazuar ne risk (shih me poshtë).

8. Te dhënat tremujore përqendrohen ne indikatorët afatshkurtër te tille si asetet dhe detyrimet, fitimet dhe humbjet, investime te ndryshimeve, risigurimi, primet dhe demet.
9. Bazuar ne shume vite te eksperiencës dhe ne analizën statistikore, faktorët kryesore parashikues per siguruesit e Shteteve te Bashkuara te Amerikës sipas sistemit IRIS (Sistemi Rregullator i Informacionit te Sigurimeve) janë si me poshtë vijon:

Raportet IRIS	Kufiri Normal Maksimal ne %	Kufiri Normal Minimal ne %
Primi bruto i shkruar ndaj kapitalit dhe tepricës statutore ⁴	900	Nuk aplikohet
Primi neto i shkruar ndaj kapitalit dhe tepricës statutore.	300	Nuk aplikohet
Ndryshimi ne primin neto te shkruar vit pas viti.	33	-33
Risigurimi mbështetës per aftësinë paguese ndaj kapitalit dhe tepricës se ligjshme .	15	Nuk aplikohet
Raporti operativ dy vjeçar	100	Nuk aplikohet
Yield-i i Investimit	10.0	4.5
Ndryshimi ne kapitalin dhe tepricën e ligjshme.	50	-10
Detyrimet ndaj asetëve likuide	105	Nuk aplikohet
Shuma e maturuar bruto nga agjentet e pjesëtuar me kapitalin dhe tepricën e ligjshme.	40	Nuk aplikohet
Zhvillimi njëvjeçar i provigjioneve te dëmeve e pjesëtuar me kapitalin dhe tepricën e ligjshme (domethënë, zhvillimi i provigjioneve duke mos marre parasysh vitin e tanishëm te sigurimit).	20	Nuk aplikohet
Zhvillimi dyvjeçar i provigjioneve te dëmeve e pjesëtuar me tepricën	20	Nuk aplikohet

⁴ Teprica e ligjshme lejon vetëm asetet e njohura (domethënë, asete qe mund te njihen sipas rregullave te sigurimit). Ajo zakonisht është me pak se sa kapitali dhe teprica e treguar ne llogarite e publikuara.

Deficiti i provigjioneve te dëmeve si % e kapitalit dhe e tepricës	25	Nuk aplikohet
--	----	---------------

10. Secili nga raportet kërkon shpjegime te detajuara kontabiliteti, duke përfshirë udhëzime mbi trajtimin e zërave te tille siç janë kostot te posedimit te shtyre ne afat dhe përcaktimi i vlerës se asetëve. Vende te ndryshme me sisteme te ndryshme kontabiliteti do te kërkojnë rregulla te ndryshme, madje ndoshta edhe raporte te ndryshme. FSA ka krijuar një grup fillestar raportesh per Shqipërinë dhe keto janë diskutuar ne detaje me poshtë. Raportet e zgjedhura padyshim do te ndryshojnë dhe evoluojnë ne kuadrin e eksperiencës dhe te ecjes se Shqipërisë drejt standardeve te kontabilitetit dhe te auditimit ndërkombëtar ose, te paktën, aty te BE-se.
11. Shifrat e kontabilitetit qe përdoren ne raportet e paralajmërimit te hershem duhet te merren nga raportet statistikore dhe financiare qe i janë dhënë mbikëqyrësit te sigurimeve dhe jo llogarite e publikuara te siguruesve. Ne shume juridiksione, shifrat e kontabilitetit qe kërkohen nga mbikëqyrësi i janë me shume konservatore se sa ato qe përdoren per llogarite qe publikohen. Kjo ndodh sepse mbikëqyrësi merret me aftësinë paguese ndërkohë qe llogarite e publikuara janë dhënë per te treguar rezultatet ekonomike te janë parashikuar ne shkallen me te mire – dy objektiva te ndryshëm.

EKZAMINIMET NE VEND -VESHTRIMI SHKURTËR⁵

12. Ekzaminimet ne vend plotësojnë dhe, ne njëfarë mase, rrjedhin nga analiza ne distance.
13. Ekzaminimet ne vend mund te kenë objektiv te plote ose objektiv te kufizuar. Ekzaminimet me objekt te plote mund te organizohen kur një sigures është ne veshtersi serioze, por qe ne mënyrë tipike ekzaminimi me objekt te plote duhet organizuar te paktën njëherë ne 3 ose 5 vjet per çdo sigures. Ekzaminimet me objekt te kufizuar kryhen kur një sigures identifikohet se ka probleme me ane te analizës se ne distance dhe bën te mundur qe mbikëqyrësi te përqendrohet ne aspekte specifike te operacioneve te siguruesve.
14. Një ekzaminim ne vend me objekt te plote do te përfshijë ekzaminimin e sa me poshtë vijon:
- (i) Procedurat dhe metodat e kontabilitetit, paraqitjen e pasqyrave financiare.
 - (ii) Vërtetimin e shifrave te dhëna ne raportet ligjore te siguruesve për mbikëqyrësin e sigurimit.
 - (iii) Verifikimin e aftësisë paguese te kompanisë se sigurimit.
 - (iv) Përcaktimin nëse siguresi ka vepruar ne përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse.

⁵ Kjo është e mbështetur pjesërisht ne materialin burimor te Shoqatës Kombëtare te Komisionerëve te Sigurimit te Shteteve te Bashkuara te Amerikës (NAIC).

15. Kjo do të përfshijë një rishikim të sa më poshtë vijon (me një theks më të madh në fushat e theksuara nga analiza në distancë):
 - (a) Historinë e kompanisë.
 - (b) Menaxhimin dhe kontrollin (duke përfshirë një referencë të veçantë ndaj procedurave të kontrollit të brendshëm).
 - (c) Mbajtjen e rekordeve dhe integritetin e sistemit të kontabilitetit.
 - (d) Kontratat e sigurimit financiar të ofruara.
 - (e) Nivelin e rritjes dhe burimet e rritjes.
 - (f) Eksperienca e humbjes – trendet dhe luhatjet – shkaqet
 - (g) Siguria dhe strategjia e risigurimit.
16. Gjate një inspektimi në vend mbikëqyrësi ka të ngjare të intervistojë personelin e nivelit të menaxhimit, audituesit e jashtëm dhe të brendshëm dhe ekspertizën aktuale. Ata mund të bëjnë edhe testime të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

MASAT SHTRËNGUESE TË BAZUARA NË AFTËSINË PAGUESE

17. Kërkesat e Shoqatës Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (NAIC) për kushtin e aftësisë paguese minimale janë që:
 - (i) Kjo është e lidhur në riskun,
 - (ii) Ndërton rrjetin e sigurisë për siguresit,
 - (iii) Është i qëndrueshëm në zbatim,
 - (iv) Siguron një bazë ligjore për mbikëqyrësin për të ndërmarrë masa shtrënguese kur kapitali dhe teprica faktike e siguresit bien poshtë nivelit që lejohet me ligj.
18. Masat lidhur me aftësinë paguese në vendet industriale konsiderojnë një gamë të gjere risqesh që mund të prekin forcën financiare të një siguresi. Për këtë arsye masat lidhur me aftësinë paguese quhet shpesh edhe kapital me bazë risku, ose RBC. Zërat e marre parasysh në përcaktimin e kapitalit me bazë risku për siguresit jojetësorë në Shtetet e Bashkuar të Amerikës përfshin sa më poshtë vijon:
 - (a) R0 – risk aseti – ente të lidhura
 - (b) Risk i stilit R1 – risk aseti – të ardhura fikse
 - (c) Risk i stilit R2 – risk aseti – kapital
 - (d) Risk i stilit R3 – risk aseti - kredit
 - (e) Risk i stilit R4 – risk nënshkrimi – provigjionet
 - (f) Risk i stilit R5 – risk nënshkrimi - primet

- (g) Korrelacionet ndërmjet disa prej këtyre risqeve që ulin nivelin e kërkuar të kapitalit.
19. Aneksi 2 tregon nivelet mesatare të RBC (Kapital me Baze Risku) që kërkohen në SHBA si rezultat i këtyre llogaritjeve dhe përbërjes së tyre.
20. Në praktike i ashtuquajturë “RBC-ja e Nivelit të Veprimit të Kompanisë” llogaritet për këto risqe dhe pjesëtohet me 2 për të nxjerre “RBC-së e Nivelit të Kontrollit të Autorizuar”. Me pas kapitale dhe teprica faktike pjesëtohen me këtë shifrën e dyte dhe veprimi rregullator varet nga raporti që del si më poshtë vijon:
- (i) Nëse raporti kalon masën 200% nuk ka nevojë për ndonjë veprim shtrëngimi.
 - (ii) Nëse raporti është më i ulët se masa 200% atëherë kompania ka nevojë të bëjë një plan për rikapitalizim.
 - (iii) Nëse raporti është ndërmjet 70% dhe 100% mbikëqyrësi mund të marrë siguruesin nën kontroll në përputhje me vendimin të atij apo të asaj.
 - (iv) Nëse raporti është nën 70% siguruesi duhet të merret nën administrim nga mbikëqyrësi – kjo është e ngjashme me shkeljen e nivelit të fondit të garancisë prej 30% të vendosura sipas regjimit të BE-së, por aftësia paguese e pikënisjes tenton të jetë e pamjaftueshme sipas regjimit ekzistues të Aftësisë Paguese I të BE-së. Një regjim i Aftësisë Paguese II, I bazuar në parimet e kapitalit me baze risku, zhvillohet aktualisht nga Komisioni Evropian.
21. Shqipëria ka të ngjarë të shkojë drejt një sistemi të tillë shtrëngimi të bazuar në aftësinë paguese, por me masa me baze risku të përshtatura me shkallën e zhvillimit të tregjeve të sigurimeve dhe të kapitalit.


ANALIZË RAPORTI NË SHQIPËRI

22. Janë identifikuar 12 raportet e mëposhtme si grupi fillestar i IRIS-it (Sistemi i Informacionit Rregullator të Sigurimeve) për sigurimin jojetësor në Shqipëri:
- (i) Norma e rritjes së primit
 - (ii) Retencioni neto
 - (iii) Raporti i dëmeve (humbjeve) neto
 - (iv) Raporti shpenzimeve
 - (v) Raporti i kombinuar
 - (vi) Raporti i të ardhurave të investimit
 - (vii) Raport të ardhurash të tjera
 - (viii) Raport operativ
 - (ix) Raport fitimi
 - (x) Kapitali dhe teprica ndaj primit bruto

- (xi) Kapitali ndaj provigjioneve teknike
- (xii) Mbulimi i aftësisë paguese


23. Këto janë diskutuar në mënyrë individuale më poshtë. Në këtë fazë në sektorin e sigurimeve në Shqipëri ka një përvojë të pamjaftueshme historike sipas standardeve moderne të kontabilitetit për të nxjerrë vlerësime treguese unike ose një profil të bazuar mbi këto raporte. Megjithatë, me kalimin e kohës, këto mund të futen. Në periudhën paraprake raportet, dhe në veçanti ato që janë të lidhura me aftësinë paguese, mund të përdoren për të përcaktuar se cili sigurues ka nevojë për mbikëqyrje më të afërt.

(i) RRITJA E PRIMIT




24. Ky raport është i rëndësishëm sepse ai mund të tregojë një numër të simptomave të presionit të mundshëm (megjithëse me qëllimin për të përcaktuar nëse janë të ligjshme me shumë në kontekstin e një analize më të thellë dhe ndoshta nevojitet zakonisht një inspektim në vend) –
- (i) Hyrje a papritur në linjat e reja të biznesit
 - (ii) Një përpjekje për të rritur qarkullimet e kesh-it për të plotësuar pagesat e detyrueshme
 - (iii) Humbje të produktit
 - (iv) Dalja nga klasa të caktuara të produktit
25. Duke pasur parasysh papjekurinë dhe masën a vogël të sektorit të sigurimit në Shqipëri mund të priten luhatje më të mëdha se sa në një treg të zhvilluar. Një game e mundshme mund të jetë plus 40% në minus 40%.
26. Informacioni shtesë për të ekzaminuar nëse raporti është pranë ose jashtë këtyre ekstremeve përfshijnë çdo ndryshim në strategjinë e marketingut, në strategjinë e shpërndarjes së politikës së vendosjes së çmimit, situatën e likuiditetit dhe mjaftueshmërinë e provigjioneve.
27. Raporte të tjera për t'u ekzaminuar nëse ky raport është i lartë përfshijnë retencionin neto, raportin e fitimit, kapitalin ndaj GWP (Primi Bruto i Shkruar) dhe mbulimin e aftësisë paguese.

(ii) RETENCIONI NETO



28. Ky raport varion ne mënyrë te konsiderueshme sipas nivelit te riskut te lidhur me kapitalin dhe tepicën qe mbështet një sigures. Një raport retencioni me i ulet se 20% shpesh tregon qe siguresi është me pranë te qënurit një broker se sa një nënshkrues real, por mund ta gjeje komisionin e këmbimit me shpërblyes se sa brokerimi. Megjithatë organizime te tilla i krijojnë mundësinë risiguresve te bëhen regjistrues te drejtpërdrejte ne tregjet ne zhvillim dhe ndoshta te nxisë zhvillimin e qëndrueshëm te siguresve vendore profesioniste. Përqindjet shume te larta te retencionit kur regjistrohen risqe te mëdha mund te jene shenje e një përpjekje për te rritur te hyrat e kesh-it për te mbuluar demet, shenje e një marrëdhënie qe përkeqësohet me risiguresit ose shenje e një aftësie qe mungon për thithjen e risigurimit – një flamur i kuq.
29. Ne vendet ne zhvillim mund te pritet zakonisht qe te shihen raporte te retencionit ndërmjet 40% dhe 80%, ne vartësi te klasës se produktit te regjistruar dhe te ligjeve vendore te detyrimeve.
30. Një ndryshim i papritur ne përqindjen e retencionit është një flamur i forte i kuq dhe ka nevojë te hetohet me shpejtësi. .
31. Gjithashtu rregulloret duhet te specifikojnë qe vetëm siguresit qe kane njëfarë sigurie duhet te ofrojnë shumicën e risigurimit te një siguresi te drejtpërdrejtë. Për sigures shume te vegjël kjo mund te jete një problem sepse ata nuk ofrojnë prim te mjaftueshëm për te tërhequr brokera te risigurimit apo edhe vete risiguresit. Ne këtë situatë një fond i bashkuar i risigurimit vendor shpesh mund te ishte i justifikueshëm.

(iii) RAPORTI I DEMEVE NETO




32. Ky raport është shume i varur nga klasa e produktit te shkruar dhe nga përfaqsjat rregullatore ndaj provigjioneve me afat te gjate (te skontuara ose te paskontuara). Për

klasat me afat te shkurtër siç është dëmtimi i pasurisë motorike apo zjarri raporti do te ishte zakonisht ndërmjet 65% dhe 80% ne një treg konkurrues qe funksionon mire. Meqenëse provigjionet mbahen vetëm për një kohe te shkurtër përpara se demt paguhet, ka një objekt te kufizuar për te fituar te ardhura investimi kështu qe primi duhet te mbuloje kostot e dëmeve dhe te shpenzimeve. E gjithë e ardhura nga investimi nevojitet për te dhënë një nivel te mjaftueshëm fitimi. Për produktet me afat te gjate mund te ketë objekt për provigjione dëmsh me te larta, por kjo ka nevojë qe te monitorohet shume nga afër.

33. Ne tregjet ne zhvillim raportet e shpenzimeve tentojnë te jene me te larta (shih tekstin e historikut) dhe ka me pak hapësirë tek primi për te mbuluar demet. Kjo nënkupton se përqindjet me te ulëta te dëmeve mund te justifikohen për një moment, por përqindjet e dëmeve me te pakta se 50% tregojnë një treg qe nuk po funksionon si duhet ose qe nuk ka provigjione te mjaftueshme për demet.
34. Ndryshimet e papritura ne raportet e dëmeve janë një flamur i kuq dhe mund te tregojnë gjera te tilla si risigurimi i dobët ose i pamjaftueshëm, ndryshimet ne strategjinë biznesit ose ndryshimet ne përfaqshen lidhur me provigjionet.
35. Asnjë sigurues nuk mund te përballojë përqindjet e larta te dëmeve ne mënyrë te pacaktuar. Megjithatë, përqindjet e dëmeve duhet te jene te larta ne mënyrë te arsyeshme nëse tregu funksionon mire për klientët e tij.


***(iv)* RAPORTI I SHPENZIMEVE**



36. Shpenzimet neto janë te barabarta me shpenzimet bruto pa komisionin e këmbimit te paguar nga risiguruesit sipas marrëveshjeve proporcionale. Komisioni i këmbimit tenton te ndihmoje një sigurues për te shlyer kostot e posedimit te produktit.
37. Raporti i shpenzimeve neto është një matje qe tregon se sa eficient është një sigurues. Ai mund edhe te tregojë fondet qe kanalizohen jashtë siguruesit për tek personat apo organizatat e lidhura me te si dhe mund te tregojë edhe përdorimin abuziv te fondeve.
38. Siç vërehet me sipër, primi i marre duhet te jete i mjaftueshëm për te paguar shpenzimet dhe demet, meqenëse e ardhura e investimit zakonisht kërkohet për te dhënë një fitim te mjaftueshëm. Nëse raporti i shpenzimit është shume i larte siguruesi do te gjeje ne fund te fundit se ai nuk mund te konkurroje për te fituar pjesën e tregut kundër operatoreve me eficientë.


39. Nëse një sigurues qe ka përdorur fort sigurimin proporcional papritmas behet subjekt i një ndryshimi qe ndodh ne normën e shpenzimeve, kjo tregon për një ndryshim te termave qe siguruesi ka përgatitur t'i ofroje siguruesit.
40. Në sigurimin jojetësor ka disa ekonomi te shkalles, megjithëse këto tentojnë te zhduken ne momentin qe një sigurues behet i madh dhe kompleks. Kështu qe një industri sigurimi me një nivel raporti shpenzimesh mesatare te larte ka te ngjare te shohë njëfarë aktivitet bashkimi. Gjithashtu ne momentin qe siguruesit e huaj hyjnë ne një treg, ata mund te përfitojnë nga eficientat ndërkufitare, kështu qe siguruesit e vegjël inefficent lokal do ta kenë te vështirë te mbijetojnë.

(v) RAPORTI I KOMBINUAR




41. Raporti i kombinuar është shuma e raportit te shpenzimeve dhe e raportit te dëmeve. Ai mat se sa pjese e primit përdoret për demet dhe për shpenzimet. Nëse raporti kombinuar është me i madh se 100% atëherë siguruesi mbështetet mbi te ardhurën e investimit dhe, nëse kjo nuk është e mjaftueshme, mbi kapitalin dhe tepricën (duke përfshire edhe rezervat) për te mbuluar demet dhe shpenzimet.
42. Një raport i kombinuar pak me pak se 100% është zakonisht një shenje e mire – një raport i kombinuar me i larte se 100% mund te jete një flamur i kuq, ose mund te tregoje thjesht qe siguruesi është një stad agresiv rritje. Ne këtë rast niveli i aftësisë paguese ka nevojë te ekzaminohet për te garantuar qe siguruesi mund te përballojë një strategji te tille.
43. Raporti i kombinuar duhet te jete një nga masat e informacionit te menaxhimit baze qe përdoret nga niveli i larte i menaxhimit ne një kompani sigurimi dhe çdo skeme nxitëse do përfshijë ndoshta përmirësime ne këtë raport.
44. Trendet ne raportet e kombinuara mund te jene një udhëzues i dobishëm lidhur me atë se nëse kompania e sigurimit është ne rrezik qe te kthehet ne një kompani ne vështërsi financiare apo jo.

(vi) RAPORTI I TE ARDHURVE TE INVESTIMI




45. E ardhura e investimit duhet te llogariten ne baze te se drejtës se konstatuar (domethënë interesat ose bonot duhet te konstatohen dhe fitimet e perealizuara kapitale dhe humbjet duhen përfshirë) ne atë mase qe është e mundur dhe shpenzimet e lidhura me investimet duhet te zbriten nga te ardhurat e investimit dhe jo te përfshihen ne shpenzimet e përgjithshme.
46. Raporti i te ardhurave te investimit është një matje e asaj se sa efikase është një menaxhim i një kompanie sigurimesh ne mbledhjen e primeve dhe ne investimin e tyre ne mënyrë te efektshme derisa te paguhen demet. Nëse agjentet dhe brokerat nuk paguajnë shpejt, atëherë kjo do te thotë se asetet qe mbulojnë demet dhe provigjionet e primeve te pafituara nuk do te përbejnë fitime te ardhurash pasi ato janë thjesht te hyra.
47. Ne kushtet e një tregu konkurrues raporti i te ardhurave te investimit tipik duhet te jete ndërmjet 4% dhe 8%. Një raport prej 5% është normalisht i mjaftueshëm për te siguruar një fitim te mjaftueshëm ndaj kapitalit nëse raporti kombinuar është 100%.
48. Siç është vërejtur me sipër, te ardhura e investimit te firuara nga një kompani sigurimi ne një treg konkurrues është burimi kryesor i fitimit – primet kërkohen për pagimin e dëmeve dhe te shpenzimeve. Sa me i mire te jete një sigures ne kthimin e shpejte te primeve ne asete te fitimit te të ardhurave aq me mire është përfitueshmëria e tij dhe aq me shpejt ai mund te rritet (sepse ai do te ketë një baze kapitale me te gjere).
49. Kompanitë e sigurimit janë ne biznesin e sigurimit te riskut, jo ne biznesin e investimit dhe asetet qe mbulojnë demet e tyre, provigjionet e primeve te pafituara dhe kërkesa minimale e aftësisë se pagesës duhet te jene likuide, te sigurta dhe te maksimizojnë te ardhurat korrente. Asetet mbi nivelin e kërkuar minimal te aftësisë se pagesës mund te investohen ne asete me afat me te gjate te tilla si prona dhe, ne një shkalle te kufizuar, prona.
50. Luhajat ne raportin e investimeve janë flamuri i kuq dhe duhet te hetohen nga mbikëqyrësi.

***(vii)* RAPORTI I TE ARDHURAVE ET TJERA**



51. Te ardhurat e tjera mund te nxirren nga riaftësimin e debitorëve (duke përfshirë edhe zëvendësimin e tyre), tarifat dhe pagesat per shpëtim prone.
52. Ndonëse nuk përbën ne mënyrë tipike një burim te rëndësishëm te ardhurash, çdo ndryshim i pazakonte ne këtë zë mund te tregojë transaksione jonormale ose te veçanta dhe duhen hetuar. Kjo mund te tregojë edhe siguruesin qe angazhohet ne aktivitete qe nuk janë te lidhura me produktin baze te sigurimit, i cili zakonisht është i paligjshëm.

***(viii)* RAPORTI OPERATIV**




53. Raporti operativ përmbledh performacën ne total te siguruesit. Ai tregon, nga pikëpamja e mbikëqyrësit, nëse siguruesi është ne gjendje te prodhojë apo jo një teprice vjetore. Nëse raporti operativ është me i larte se 100% atëherë aksionerët e siguruesit po subvencionojnë nivelin menaxhues dhe te siguruarit.
54. Ne fakt përqindja duhet te jete saktësisht 100% pa pjesën e përqindjes se te ardhurës se investimit qe nxirret kapitali dhe teprica (domethënë, fondet e aksionerëve) meqenëse aksionerët do te ishin ne gjendje te fitonin me shume para thjeshte duke i investuar ato ne tregun e kapitalit nëse aktivitetet e sigurimit sjellin humbje. Disa sigurues ne fakt

bëjnë ndarjen e te ardhurave te investimit ne pjesën qe vjen nga fondet e aksionerëve (kapitali dhe teprica) dhe pjesa qe vjen nga te hyrat e primit (netoja e te hyrave te dëmeve dhe shpenzimeve), dhe i përdorin keto te fundit vetëm ne përcaktimin e te ardhurave te investimit dhe te përqindjeve operative.


55. Trendet ne rastin e përqindjes operative do te tregojnë nëse performanca e një siguruesi është duke u përmirësuar ose është duke u përkeqësuar dhe mund te tregojë nevojën per ndërhyrje mbikëqyrëse ose, te paktën, një hetim me kërkues duke përfshirë ndoshta edhe një inspektim ne vend.

(ix) PËRQINDJA E FITIMIT



56. Përqindja e fitimit është thjeshte një mënyrë tjetër e te shikuarit te përqindjes operative. Ajo tregon marzhin neto te disponueshëm per aksionerët dhe per taksen e fitimit te kompanisë pasi janë kryer operacionet kryesore.

(x) KAPITALI DHE TEPRICA NDAJ PRIMIT BRUTO




57. Kapitali dhe teprica qe përdoren per qëllimet e këtij raporti duhet te jene pas zbritjes se asetëve te paaprovuara (ose te aprovuara) dhe pasi janë krijuar provigjione te mjaftueshme.
58. Ky raport mat se sa prim mund te shkruhet per një njësi te fondeve te aksionerëve. Nëse biznesi është rentabël, atëherë aksionerët do te duan te maksimizojnë shumen e produktit qe ata shkruajnë relative ndaj investimeve te tyre ne kompani. Megjithatë, sa me shume produkt shkruan një kompani, aq me i madh është potenciali per luhatje ne

rezultate dhe aq me e madhe është nevoja për kapital për të mbuluar luhatjet negative – pra ka një kombinacion. Ligji përcakton fuqinë maksimale të investimit që një kompani mund të përdorë.


59. Nëse përqindja rritet shumë, atëherë mbikëqyrësi duhet të ndërmarrë veprime shtrënguese në shumicën e juridiksioneve.
60. Një trend rritës në këtë përqindje mund të jetë një indikator se një kompani sigurimi po vihet në vështersi. Në mënyrë tipike përqindja do të jetë në kufijtë ndërmjet 2 deri tek 5 për një sigurues të drejtpërdrejtë që siguron produkte me afat të shkurtër.

(xi) KAPITALI DHE TEPRICA NDAJ PROVIGJIONEVE TEKNIKE



61. Provigjionet teknike janë shuma e provigjioneve të dëmeve, provigjionet e primit të pafituruar dhe provigjionet e çdo risku të paskaduar. Ato duhet të jenë mbi bazën e një risigurimi neto.
62. Ky raport tregon se sa diapazon ka gabim tek provigjionet teknike dhe është e lidhur me konceptin e vlerës në risk përdoret në banka, dhe në mënyrë të rritur në nen-sektorë të tjerë financiarë. Përqindja duhet të jetë në mënyrë tipike të paktën 20% (me fjale të tjera ka një marzh gabimi prej 20% në provigjionet teknike përpara se siguruesi të falimentojë).
63. Ndryshimet në këtë përqindje mund të tregojnë standardet e privigjionimit ose thjesht një përmirësim apo përkeqësim të gjendjes së aftësisë paguese.

(xii) AFTËSIA PAGUESE



64. Ky është raporti baze i cili nxit shtrëngesën rregulatore dhe, madje, vënien e siguruesit nën administrim nga mbikëqyrësi. Siç vërehet, në juridiksione të tjera mbikëqyrësit

mund te marrin kontrollin e një siguruesi kur fondet e aksionerëve të tij të matur nëpërmjet përdorimit të standardeve të kontabilitetit të fitimit ligjor bien nën 50% të aftësisë paguese minimale të kërkuar. Përpara kësaj një siguruesi i kërkohet të bëjë një plan rikapitalizimi.

65. Zakonisht një mbikëqyrës duhet të ketë ndërhyrë shumë me përpara se kur marzhi i aftësisë paguese faktike të siguruesit të ketë rënë poshtë minimumit ligjor, bazuar mbi këtë dhe mbi përqindje të tjera paralajmëruese të hershme. Veprimet e kërkuara mund të kenë përfshirë ndërprerjen e sigurimit të klasave të caktuara të produktit, ndryshimi e një personeli të caktuar të menaxhimit dhe bërjen e një plan-biznesi për të korrigjuar situatën.
66. Marzhi i aftësisë paguese faktike për një sigurues jojetësorë të drejtuar mirë është zakonisht të paktën 200% i minimumit të kërkuar. Kur përqindja bie poshtë kësaj, mbikëqyrësi do të fillojë zakonisht të monitorojë siguruesin me nga afër në një ambient të një vendi industrial.

KUFIJTË NORMALE – VENDET NE ZHVILLIM

Përqindja	% Fundore e Larte	% Fundore e Ulet
Norma e Rritjes se Primit	+40	-40
Retencioni Neto	80	40
Shpenzimet	50	25
Demet Neto	80	50
E kombinuar	105	85
E Ardhura e Investimit	8	4
E Ardhur Tjetër	1	N/A
Operative	101	80
Fitimi	20	-1
Kapitali dhe Teprica ndaj Primit Bruto te Shkruar	50	20
Kapitali dhe Teprica ndaj Provigjioneve Teknike	30	10
Aftësia Paguese	300	150

ANEKSI 1 – SHKALLA RREGULLATORE KANADEZE

UDHËZUES MBIKËQYRJEJE E ZBATUESHME NE KOMPANITË E SIGURIMIT JETËSOR TE RREGULLUARA NE
MËNYRË FEDERALE


RISHIKUAR NE MARS 1997 PER TE PËRFSHIRË AKTIVITET OSFI/COMP CORP CO-OPERATION DHE
COMP CORP

- [FAZA 0](#) – NUK KA PROBLEME /AKTIVITETE NORMALE
- [FAZA 1](#) – PARALAJMËRIM I HERSHEM
- [FAZA 2](#) – RISK NDAJ REALIZUESHMËRISË FINANCIARE OSE AFTËSISË PAGUESE
- [FAZA 3](#) – REALIZUESHMËRI E ARDHSHME FINANCIARE NE DYSHIM SERIOZ
- [FAZA 4](#) – KOMPANIA PA MUNDËSI FITIMI/FALIMENTIMI EMINENT

ANEKSI II – KËRKESAT (RBC) PER AFTËSINË PAGUESE MINIMALE MESATARE NE SHBA

Krahasimi i Riskut sipas Modelit Kapital te SHBA-se

Figure 3
Risk-based capital of US property & casualty
and life insurers in 2003



[1] Including health credit risk, 0.002% of technical provisions

[2] The tax sensitivity test cancels the tax discounts included in all risk categories by assuming that the company is not a taxpayer, that its losses are of no value to another taxpayer, and that its deferred total assets and deferred total liabilities are zero.

Source: NAIC